

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TETOR-DHJETOR 2025

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	06.10.2025	Kërkesë për saktësim mbi kërkesën e shfaqur në sistemin e AZHT	06.10.2025	Në vijim të kërkesë-ankesës tuaj datë 06.10.2025 ju bejmë me dije se problematika që ju keni shfaqur është jashtë fushës së përgjegjësisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, pasi hapi pasues në sistem nuk është zgjedhur nga IKTK, por është veprim automatik i sistemit e-leje. Për këtë arsye problematika e aplikimit tuaj i është përcjellë nga ana jone ekipit te suportit teknik prane AKSH-it..	E plotë	Jo
2	06.10.2025	Kërkesë për materiale arkivore për pasurië kulturore me emërtimin “Banesa e Muharrem Korbit”, shpallur Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, e ndodhur në fshatin Gurrë e Madhe, Njësia Administrative Klos, Bashkia Klos, materialet e kërkuara përfshijnë: Dokumentacion grafik ekzistues (plane, prerje, fasada, rilevime); Relacionet dhe dokumentet e ndërhyrjeve të mëparshme; Fotografi arkivore apo materiale të tjera historike referuese.	10.10.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju bejme me dije se: Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojmë dosje teknike per objektin pasuri kulturore "Kulla e Elmaz (Muharrem) Korbit" ne fshatin Gur i Bardhë, Klos me dokumentacionin arkivor si më poshtë vijon: - Rilevime te objektit; - Ndërhyrje restauruese ndër vite; - Foto historike. Sa me sipër, në kuadër të hartimit të projektit te restaurimit, ju dergojme bashkelidhur dokumentacionin arkivor per objektin ne studim. https://ëëë.transferxl.com/it/download/08vm5L5DëP2F0f	E plotë	Jo
3	07.10.2025	Informacion mbi objektin “Rikonstruksion i rrugës Via Egnatia” në Peqin, Elbasan ndikimin e tij mbi urën e Fatishës, gjurmët e rrugës dhe monumentet e kulturës në këtë zonë.	17.10.2025	Bashkëlidhur gjeni përgjigjen e hartuar nga IKTK në lidhje me kërkesën tuaj për rikonstruksionin e Vijës Egnatia: <i>A është kërkuar dhe dhënë nga IKTK miratim për ndërhyrjen në segmentin e rrugës ku ndodhet ura e Fatishës, specifikisht për projektin “Rikonstruksion i rrugës Via Egnatia”?</i>	E plotë	Jo

				Lidhur me pyetjen e pare ju informojmë se: Në datë 27.11.2024, në sistemin E-Lejet Bashkia e Peqinit ka aplikuar projektin “Rikonstruksion i rrugës ekzistuese dhe restaurim i fragmentit të kalldrëmit të Rrugës Egnatia”, datë 27.11.2024, projekt i miratuar me vendim të KKTKM Nr. <u>531</u> date 13.12.2024. <i>A ka prekur projekti “Rikonstruksion i rrugës Via Egnatia” ndonjë objekt të shpallur Monument Kulture? Nëse po specifikoni. A ndodhen monumente kulture në zonën ku shtrihet ky projekt dhe, nëse po, cilës kategori i përkasin?</i> Lidhur me këtë pyetje ju informojmë se Rruga e propozuar për rikonstruksion në projektin e aplikuar në sistemin E-Lejet shtrihet në të dyja krahët e një segmenti të “Vijës Egnatja” monument kulture kategoria e I-rë dhe më konkretisht atë në afërsi të “Urës së Fatishës”, monument kulture kategoria e I-rë. <i>Si e vlerëson IKTK përshtatshmërinë e asfaltimit në këtë rrugë, në një zonë me vlera të trashëgimisë kulturore?</i> <i>dhe</i> <i>Çfarë rekomandimesh ose alternativash teknike ka dhënë IKTK për ruajtjen e kalldrëmeve dhe të urës gjatë ndërhyrjes?</i> Referuar pyetjes 3 dhe 4 sqarojmë se: Projekti i sipërcituar është aplikuar në sistemin E-Lejet referuar ligjit të trashëgimisë kulturore 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe është shqyrtuar nga instancat përkatëse referuar këtij ligji si dhe VKM Nr. 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”. <i>A ka pasur aplikim zyrtar nga Bashkia Peqin pranë institucionit tuaj për këtë projekt dhe a është kryer një vlerësim i ndikimit mbi trashëgiminë kulturore?</i>		
--	--	--	--	--	--	--

				Lidhur me këtë pyetje sikurse është cituar edhe me lartë, Bashkia Peqin ka aplikuar në sistemin E-Lejet në datë 27.11.2024 <i>A konsiderohet ura e Fatishës dhe segmenti i Via Egnatia pjesë e trashëgimisë së mbrojtur sipas ligjit, dhe a është vlerësuar ndikimi i projektit mbi këto elemente?</i> Lidhur me këtë pyetje sqarojmë se: objekti “Ura e Fatishës” dhe segmenti i “Via Egnatias” janë pasuri kulturore dhe si të tilla mbrohen nga ligji të trashëgimisë kulturore 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe çdo ndërhyrje vlerësohet referuar VKM Nr. 1099, datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”.		
4	09.10.2025	Kërkesë për informacion mbi zhvillimin e projektit të restaurimit të objektit “Ish Prefektura”, Vlorë	10.10.2025	Në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se projekti ka përfunduar, është aplikuar në sistemin e-leje, shqyrtuar dhe percjelle vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Ne vijim do të njoftoheni për finalizimin e këtij procesi.	E plotë	Jo
5	12.10.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e legalizimit të objektit informal	13.10.2025	Në vijim të ankesës bashkëlidhur me subjekt kerkues z. _____, ju bëjmë me dije se kjo kërkesë është miratuar në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, me vendim nr. 41 datë 17.01.2025. Me shkresë nr. 44/1 prot date 24.01.2025, IKTK ka përcjellë në adresë të ASHK Lezhë vendimin e miratimit në parim të kërkesës për vijimin e procedurës së legalizimit. Kërkesa është e ezauruar nga IKTK, Ju duhet të ndiqni në vijim procedurën me ASHK Lezhë.	E plotë	Jo
6	15.10.2025	Kërkesë për materiale arkivore për objektin "KALAJA E PEPELIT", Monument Kulture Kategorja e Pare, shpallur me Vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës/nr.266/1/dt.16.02.1979.	16.10.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju bejme me dije se: Ne Arkivin Teknik të IKTK-se disponojmë dosje teknike për objektin pasuri kulturore "Kalaja e Pepelit", në qarkun Gjirokaster, me dokumentacionin arkivor si me poshte vijon:	E plotë	

				• Rilevime te objektit; • Foto historike. Sa me siper, ju dergojme bashkelidhur dokumentacionin arkivor per objektin ne studim, ne kuader te hartimit te projektit te restaurimit. https://www.transferxl.com/it/download/08j2NHmY2knPb https://www.transferxl.com/it/download/084TMy3EB5Ngy		
7	16.10.2025	Sqari mbi vendimin e KKTKM-së	17.10.2025	Në vijim të shqyrtimit të kërkesës së Z. Zela, për sa i përket vendimarrjes së KKTKM për objektin në fjalë, si dhe për kërkesën për ndryshim emertimi, sqarojmë si vijon: Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 27/2018 "Për Trashëgimë Kulturore dhe Muzetë" dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për zonifikimin arkeologjik të qytetit të Durrësit", IKTK në çelësine e Sekretarise Teknike të Keshillit Kombëtar të Trashëgimise Kulturore Materiale (KKTKM), dhe me pas KKTKM, shqyrton dhe vlerëson çdo propozim për nderhyrje në zonat arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit, duke marrë në konsideratë impaktin e secilit propozim mbi pasurinë arkeologjike të zonës. Pas çdo shqyrtimi, KKTKM duke vlerësuar propozimin mbi bazën ligjore aktuale si dhe në varësi të shkallës së impaktit mbi zonën arkeologjike, del me vendimin përkatës dhe rekomandime nëse vlerësohet e nevojshme. Sqarojmë gjithashtu se, Vendimi i KKTKM është një dokumentacion plotësues dhe nuk është leje ndertimi, për të cilën është kompetente Bashkia Durrës. Për rastin në fjalë, emertimi në vendimin e KKTKM nr. 81 datë 26.04.2024, është pasqyrim i emertimit të raportit arkeologjik dhe	E plotë	

				projektit bashkelidhur aplikimit. Nga ana e Sekretarise dhe IKTK-se nuk ka asnje gabim ne emertimin e projektit. Po ashtu, sqarojme se prane IKTK-se nuk eshte administruar asnje kerkese zyrtare per pasaktesi ne lidhje me emertimet e vendimeve te KKTKM per kete rast, apo per raste te tjera. Sjellim ne vemendje edhe raste analoge, ku me te njejten permbajte te vendimeve te KKTKM, Bashkia Durres ka vijuar me procesin e zbardhjes se lejes se ndertimit, te cilat i gjeni bashkelidhur. Gjithashtu, ju bejme me dije se prane IKTK-se nuk eshte depozituar asnje kerkese zyrtare ne lidhje me "paqartesi te mundshme" mbi vendime te caktuara nga ana e KKTKM-së.		
8	16.10.2025	16.10.2025 "Kerkese për dokumentacion"	31.10.2025	Në vijim te kërkesës suaj date 16.10.2025 "Kerkese per dokumentacion", administruar pranë IKTK me Nr. 2067 Prot., date 20.10.2025 ju bëjmë me dije se: Referuar Udhëzimit te përbashkët te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nr. 5, datë 27.8.2025 "Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga instituti kombëtar i trashëgimisë kulturore", (bashkëlidhur), kërkesa juaj është duke u shqyrtuar. Ju informojmë se do te viheni ne dijeni ne vijim mbi faturën për arkëtim qe do te paguani, me qellim tërheqjen e dokumentacionit te kërkuar.	E plotë	Jo
9	30.10.2025	Informacion mbi aplikimin për pajisje me licence të nivelit A2 në arkeologji	03.11.2025	Ne pergjigje te kerkeses tuaj derguar ne adresen zyrtare te postes elektronike te IKTK, JU bejme me dije si vijon: Ne vijim te korrespondences mbi plotesimin e dokumentacionit, IKTK ka vijuar me shqyrtimin e dokumentacionit ne perputhje me percaktimet e VKM Nr. 793, datë 7.10.2020 "Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kriterëve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore", të ndryshuar.	E plotë	Jo

				Ju informojme se aplikimit juaj me nr. IKTK-2025-6104412-AG, eshte ne proces shqyrtimi ne Keshillet perkatese prane IKTK.		
10	06.11.2025	Informacion mbi objektin pasuri kulturore "Banesa e Shaqir (Elmaz) Dezhgiut, ne fshain Gur i Bardhë, Klos	10.11.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju bejme me dije se: Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojme dosje teknike per objektin pasuri kulturore "Banesa e Shaqir (Elmaz) Dezhgiut, ne fshain Gur i Bardhë, Klos me dokumentacionin arkivor si me poshte vijon: • Foto historike. • Rilevime te objektit; • Nderhyrje restauruese nder vite. Sa me siper, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimit te përbashkët te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nr. 5, datë 27.8.2025 "Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga instituti kombëtar i trashëgimisë kulturore" (pika 5), ju dergojme bashkelidhur dokumentacionin arkivor ne format elektronik pdf. per objektin ne studim, ne kuader te hartimit te projektit te restaurimit. https://www.transferxl.com/it/doenload/08v7xdnjdB1Nd	E plotë	
11	06.11.2025	Kërkesë për informacion mbi objekti “Guri i Përmetit”,	10.11.2025	Në vijim te kërkeses per informacion mbi “Gurin e Përmetit”, bashkelidhur pergjigje per sa parashtruar: 1. A është Ministria e Kulturës, Turizmit dhe Sportit institucioni që ka inicuar apo mbështetur projektin për ndërtimin që po kryhet pranë Gurit të Përmetit? #Nëse po, kërkojmë emrin e projektit, qëllimin dhe burimin e financimit. • IKTK nuk disponon informacion për këtë pyetje.	E plotë	Jo

				2. A ka dhënë Ministria miratim apo autorizim për këtë ndërtim, nëpërmjet strukturave të saj vartëse (IKTK, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, etj.)? - Projekti është shqyrtuar dhe miratuar në KKTKM me Vendim Nr. 506, datë 06.12.2024. 3. A është zhvilluar ndonjë vlerësim i ndikimit kulturor apo mjedisor, sipas ligjit për trashëgiminë kulturore dhe për zonat e mbrojtura, përpara fillimit të punimeve? - IKTK nuk disponon informacion. 4. A ka korespondencë ndërinstytucionale ndërmjet Ministrisë dhe Bashkisë Përmet lidhur me këtë projekt? #Nëse po, kërkojmë kopje të komunikimeve zyrtare dhe akteve përkatëse. - IKTK nuk disponon informacion. 5. A janë zhvilluar dëgjesa publike për këtë projekt? - IKTK nuk disponon informacion. 6. Nëse po, ju lutemi të na informoni kur janë mbajtur, kush ka marrë pjesë dhe cilat kanë qenë rekomandimet e dala nga to. 7. A ka investuar më herët kjo ministri në Bashkinë Përmet për zyra informacioni turistike, qendra mikpritjeje apo projekte të zhvillimit të turizmit kulturor? - IKTK nuk disponon informacion. Nëse po, ju lutemi të na dërgoni listën e projekteve, vitet e zbatimit dhe fondet e akorduara.		
12	21.11.2025	Kërkesë për hapjen e llogarisë Webgis	25.11.2025	Ju bëjmë me dije se llogaria juaj është aktivizuar dhe do te logoheni me kredencialet që do të dërgohen me email.	E plotë	Jo

13	27.11.2025	Kërkesë mbi materialet arkivore të godinës aktuale të Bashkisë Shkodër (ish-Prefektura).	02.12.2025	Në vijim të kërkesës suaj, ju bëjme me dije se, Ju duhet te paraqiteni prane Arkivit Teknik te IKTK per te seleksionuar materialet qe ju nevojiten. Dokumentacioni do te vihet ne dispozicionin tuaj sipas parashikimeve te Udhezimit te perbashket te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit (sot Ministria e Turizmit, Kul Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, ushtron veprimtarinë e tij sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në funksion të tij. Referuar objektit të kërkesës suaj, bëjmë me dije se IKTK në zbatim të nenin 29 të Ligjit nr. 27/2018, i ndryshuar nuk ka kompetenca ligjore për të shfuqizuar shkresa të cilat janë dërguar më parë, institucioneve shtetërore mbi vijueshmërinë e procedurave specifike. IKTK nuk ka asnjë tagër ligjor që të njoftojë institucionet e cituara në kërkesën tuaj mbi përditësimin e rastit. Ashtu sikur jeni bërë me dije edhe në shkresën e pezullimit të punimeve, deri në ndjekjen e procedurave sipas përcaktimeve ligjore ky pezullim mbetet në fuqi. Në rast mos pajtimi me procedurat e zbatuara nga institucioni, ju mund ti drejtoheni organeve kompetente për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes tures dhe Sportit) mbi percaktimin e tarfave.	E plotë	Jo
14	02.12.2025	Kërkesë për shfuqizimin e shkresave të dërguara më parë mbi pezullimin e punimeve.	16.12.2025			
15	05.12.2025	Kërkesë për informacion te dokumentacionit dhe institucionit te duhur per te aplikuar ne e-albania, per instalimin permanent te nje monumenti ne “Burgun e Spacit”.	05.12.2025	Për të vlerësuar kërkesën tuaj, ju lutem të na dërgohet informacion i mëtejshëm mbi i monumentin dhe instalimin (lokacionin) e tij në Burgun e Spaçit, shpallur, MK-II me vendimin e MTKRS/nr.656/dt.05.12.2007 , si dhe bashkëlidhur dokumentacionin përkatës (planvendosje, projekt).	E plotë	Jo

16	12.12.2025	Kërkesë per materiale arkivore per Monumentin: Kulla e Bajram Allushit ne Klos Katund.	12.12.2025	Ju bëjmë me dije se, ju duhet te depozitoni kërkesën tuaj sipas modelit te miratuar me ligjin nr. 119/2014 "Për te drejtën e informimit", bashkëlidhur këtij e-mail. Dokumentacioni do te vihet ne dispozicionin tuaj sipas parashikimeve te Udhëzimit te përbashkët te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (sot Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit) mbi përcaktimin e tarifave.	E plotë	Jo
17	18.12.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me objektet 1. Universiteti i Tiranës – Sheshi Nënë Tereza; 2. Biblioteka e Universitetit – Sheshi Nënë Tereza; 3. Akademia e Arteve; 4. Muzeu Arkeologjik – Sheshi Nënë Tereza; 5. Pallati i Kongreseve; 6. Stadiumi kombetar Qemal Stafa.	23.12.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju bejme me dije se: Prane Arkivit teknik te IKTK lidhur me objektet ne studim ne qytetin e Tiranes te listuara si me poshte disponojme vetem projekte te reja te viteve te fundit, te cilat janë me te drejte autori. 1. Universiteti i Tiranës – Sheshi "Nënë Tereza" 2. Akademia e Arteve 3. Muzeu Arkeologjik – Sheshi "Nënë Tereza" 4. Pallati i Kongreseve 5. Stadiumi kombetar "Qemal Stafa" Lidhur me objektin: Biblioteka e Universitetit – Sheshi Nënë Tereza nuk disponojme materiale arkivore (planimetri, skica etj.) Per sa me siper, bazuar në ligjin Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit”, perkatesisht neni 17, projektet nuk mund tju vendosen ne dispozicion pasi permbajne te dhena te cilat cenojne te drejten e autorit, duke mos patur miratimin paraprak me shkrim nga ana e tij. Gjithashtu, mbështetur në Ligjin nr 35/ 2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, perkatesisht neni 8, gërma e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike ne projektet arkitekturore, jane objekt i se drejtes se autorit. Ju informojmë se lidhur me dokumentacionin e kërkuar mund të drejtoheni pranë Arkivit Qendror	E plotë	Jo

				Teknik të Ndërtimit (AQTN), si dhe mund të shfrytezoni literaturën e bibliotekës së IKTK-së.		
18	18.12.2025	Kërkesë për materiale arkivore “Restaurim dhe rehabilitim i fasadës” për objektin Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbënor” (Piramida), Monument Kulture i Kategorisë II.	23.12.2025	Në vijim të kërkesës Suaj, mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje digjitale të projekteve që disponojmë për objektin pasuri kulturore: Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbënor” (Piramida). Gjithashtu, mbështetur në Ligjin nr 35/ 2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://www.transferxl.com/it/download/08BK5CcK_KgQNK https://www.transferxl.com/it/download/08pwmJPs4h16H https://www.transferxl.com/it/download/08jTDvJmvz0qm9 https://www.transferxl.com/it/download/08jQ02dPCTqcwf.	E plotë	Jo